



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 697 Prot.

Tiranë, më 28.05 2018

VENDIM Nr. 99, datë 14.05.2018

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 30, VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërbllimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 5, datë 14.05.2018, pasi shqyrtoi Konceptin e sondazheve arkeologjike në kuadër të *projektit "Teleferiku Krujë-Mali Krujë (Sari-Salltik)" në Zonë arkeologjike "B"*-subjekti "URBANTRANS" sh.p.k., paraqitur nga shoqëri e licencuar në arkeologji "AD-STAR" sh.p.k..

VENDOSI:

1. Të miratojë Konceptin sondazheve arkeologjike në kuadër të *projektit "Teleferiku Krujë-Mali Krujë (Sari-Salltik)" në Zonë arkeologjike "B"*-subjekti "URBANTRANS" sh.p.k., paraqitur nga shoqëri e licencuar në arkeologji "AD-STAR" sh.p.k.
2. Subjekti "URBANTRANS" sh.p.k. duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje tre palëshe me shoqëri të licencuar në arkeologji, e cila do të realizojë sondazhet arkeologjike, si dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, e cila do të mbikëqyrë këtë shoqëri. Raporti i tyre do të paraqitet në KKA e radhës.
3. Investitori "URBANTRANS" sh.p.k. duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr.384, datë 21.10.2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.
4. Investitori "URBANTRANS" sh.p.k. si dhe shoqëria e licencuar në arkeologji, e cila do të kryejë sondazhet arkeologjike, në mbështetje të Ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Rregullores "Mbi kriteret e ushtrimit të profesionit të arkeologut" dhe akt-marrëveshjes tre palëshe të sipërcituar, janë të detyruar të marrin të

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: asha.gov.al

gjitha masat për sigurimin dhe ruajtjen e kantierit, si dhe ruajtjen e strukturave arkeologjike, të cilat mund të zbulohen gjatë kryerjes së sondazheve, deri në vendimmarrjen përfundimtare të KKA, në lidhje me to.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTER



SEKRETARI I KKA

RUDINA ZOTO

